Bazuar në nenin 8 dhe 9 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare Nr. 03/L-060, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve nxjerr:

Rregulloren e punës
të Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve

Neni 1
Dispozitat e përgjithshme

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e punës, (thirrja dhe mbajtja e mbledhjeve, mënyra e vendimmarrjes, zgjedhja dhe shkarkimi i Kryetarit dhe zëvendës Kryetarit te Këshillit Drejtues), dhe çështjet e tjera relevante.

Neni 2
Këshillit Drejtues

Bazuar në nenin 8 dhe 9 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare (Ligji Nr. 03/L-060, datë 7 Nëntor 2008), Këshilli Drejtues është organe vendimmarrës i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (tash e tutje AKA).

Neni 3
Përbërja dhe zgjedhja e Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues përbëhet nga 13 anëtarë nga radhët e të dy gjinive.
2. Përbërja e Këshilli Drejtues aprovohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.
3. Drejtori i AKA-së është anëtar ex-officio i Këshilli Drejtues dhe vepron si sekretar i këtij këshilli pa të drejtë vote.
4. Anëtarët e Këshilli Drejtues jenë të deleguar nga institucionet përkatëse të përcaktuara në pikën 2 të nenit 8 të Ligjin për Kualifikimet Kombëtare (Ligji Nr. 03/L-060).
5. Anëtarët e Këshilli Drejtues ushtrojnë detyrën e tyre bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, respektimin e plotë të lirisë dhe pavarësisë profesionale, si dhe duke u bazuar në standarde të larta etike.